



BASHKIA
TIRANË



AGJENCIA E
MBROJTJES SË
KONSUMATORIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 10/12/2020

Nga: Autoriteti Kontraktor Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Tiranë

Për: "SHEHDULA" sh.p.k. me Nr. NIPTI J61827501H

Adresa: Lagjja 14, Durrës

Procedura e prokurimit: "Blerje të mjeteve mjekësore veterinare", "E Hapur" me mjete elektronike.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-74446-10-08-2020

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Blerje të mjeteve mjekësore veterinare për të realizuar procesin e sterilizimeve dhe rivaksinimeve të qenëve endacakë në qytetin e Tiranës.

Fondi limit total: 12,554,650 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Financim nga Bashkia Tiranë në mbështetje të Vendimit Nr.157 datë 26.12.2019 të Këshillit Bashkiak të Tiranës për "Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020".

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.11.2020

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik **“KRISTAQ SKENDERI” (Person Fizik)** me Nr.NIPTI: K32720203N, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2. Operatori ekonomik **“ALMedical” sh.p.k.** me Nr.NIPTI: K21511002I, ka paraqitur ofertën ekonomike 9,840,000 (nëntë milion e tetëqind e dyzetë mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik **“SHEHDULA” sh.p.k.** me Nr.NIPTI: J61827501H, ka paraqitur ofertën ekonomike 12,071,700 (dymbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **“KRISTAQ SKENDERI” (Person Fizik)** me Nr. NIPTI: K32720203N.
2. Operatori ekonomik **“ALMedical” sh.p.k.** me Nr. NIPTI: K21511002I.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- I. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **“KRISTAQ SKENDERI” (Person Fizik)**, është konstatuar se:
 - Nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentat e kërkuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.
 - Operatori ekonomik nuk u paraqit në orën e caktuar për dorëzimin e mostrave të kërkuara.

- II. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik **“ALMedical” sh.p.k.**, është konstatuar se:

Referuar mostrave të dorëzuara u konstatua se disa prej tyre nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara, përkatësisht si më poshtë:

- Mostra me numër rendor 18 **Maska operacioni një përdorimëshme**; Ky është një produkt që përdoret në kirurgji (sterilizimet / kastrimet e qenve endacakë). Paketimi i mostrës së sjellë e specifikion qartësisht që produkti nuk është për përdorim mjekësor.
- Mostra me numër rendor 21 **Gjilpëra atraumatike**; Mostra e sjellë (specifikimet në paketimin e produktit) është age spinale, e cila përdoret për injektimin e preparateve në kanalën spinal (shtyllën kurrizore). Pra, nuk është sjellë fare produkti i kërkuar, i cili është një gjilpërë kirurgjikale që përdoret për qepje gjatë ndërhyrjeve në kirurgji. Quhet atraumatike pasi është e dizenuar në formën e një gjysëm rrethi (e harkuar), për të

minimizuar dëmtimin e indeve dhe mos shkaktimin e plagëve apo traumave gjatë përdorimit.

Nga verifikimet e kryera për mostrat rezulton si më poshtë:

- Mostra e sjellë për produktin me numër rendor 23 **Fipronil 134 mg 10-20 kg** me emër tregtar “Fiprodog 134 mg”, nuk është e miratuar për tu tregëtuar në Republikën e Shqipërisë nga Komisioni Shtetëror i Produkteve Mjekësore Veterinare (PMV).

Ligji Nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 1 të nenit 85, përcakton se **produktet mjekësore veterinare lejohen të tregëtohen në Republikën e Shqipërisë vetëm kur janë të miratuar nga Komisioni Shtetëror i Produkteve Mjekësore Veterinare**. Në nenin 86 të këtij ligji theksohet se **asnjë produkt mjekësor veterinar nuk lejohet të tregtohet pa certifikatë tregtimi**, me përjashtim të rasteve kur përdoret për qëllime të provave klinike të Produkteve Mjekësore Veterinare (PMV).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “SHEHDULA” sh.p.k. me Nr. NIPTI: J61827501H, Adresa: Lagjja 14, Durrës, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 12,071,700 (dymbëdhjetë milion e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta më e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Rr. “Abdi Toptani”, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Së bashku me sigurimin e kontratës duhet të sillni të gjithë dokumentacionin e paraqitur në tender (original ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO dhe bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet për mungesë konkurrence, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.12.2020

Ankesa: Në datën 13.10.2020 pranë zyrave të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, u paraqit ankesa me Nr.1820 Prot. nga operatori ekonomik “ALMedical” shpk për Dokumentat Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik u vu në dijeni për përgjigjen me shkresën Nr.1820/1 Prot. datë 15.10.2020.

Në datën 23.10.2020 jemi vënë në dijeni, për vendimin me Nr.1318/1 Prot., të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në datën 04.11.2020 jemi vënë në dijeni, për zbatimin e vendimit Nr.496 Prot., të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në datën 13.11.2020 jemi vënë në dijeni, për heqjen nga pezullimi sipas vendimit Nr. 496/3/2020 Prot., të Komisionit të Prokurimit Publik.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Rudina HOXHA